



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË

V E N D I M

Nr. 2 Datë 05.09.2017

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE
“PËR PËRDORIMIN E BURIMEVE UJORE”**

Në mbështetje të nenit 7, nenit 38 gërma b; nenit 41, nenit 50; nenit 51; nenit 52 dhe nenit 53 të ligjit nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore“ dhe të VKM Nr.416 datë 13.05.2015, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje për përdorim të burimeve ujore”, bazuar në relacionin e paraqitur nga A.B.U. Drin – Bunë, miratimin në parim të Këshillit Konsultativ dhe oponencës së DPBU në ministrinë përgjegjëse për administrimin e burimeve ujore, Këshilli i Basenit Ujor Drin- Bunë:

V E N D O S I :

1-Të miratojë kërkesën e subjektit “KANTINA MIQËSIA 1” sh.p.k. me administratore Znj.Vjollca LIKAJ për leje për përdorim të burimit ujor **Pus shpimi** si ujë sanitar për Kantinën e veres Miqësia 1, me vendndodhje në fshatin Kalldrun, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.

Koordinatat e pusit të shpimit: X - 46 76 432; Y – 43 70 233; Z – +20.8 m;

Thellësia e pusit : 26 m;

Diametri i pusit: 200 mm

Sasia e ujit që kërkohet të përdoret nga subjekti është 3.5 l/sek.

2-Leja e përdorimit të burimit ujor jepet me kusht që të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zone dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

3-Ngarkohet A.B.U. Drin- Bunë për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR DRIN-BUNË

SEKRETAR

Martin PLLUMBI



KRYETAR

Paulin RADOVANI